



RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Fushë Kosovë

2025

Përmbatja

P J E S A I.....	5
DISPOZITAT HYRËSE	5
Neni 1	5
Përmbajtja dhe zbatimi i Rregullores.....	5
Neni 2	6
Shkurtesat dhe Përkufizimet.....	6
Neni 3	7
Vendet zyrtare	7
Neni 4	7
Lokalet, pajisjet, instalimet dhe mjetet tjera për punë	7
Neni 5	7
Personeli	7
Neni 6	8
Organizimi i punës në stacion	8
Neni 7	9
Koha e punës.....	9
Neni 8	9
Orari i Lëvizjes së Trenave – OLT.....	9
Neni 9	9
Organizimi i trajnimit, shkollimit të rregullt dhe mbikëqyrja e punonjësve ekzekutivë.....	9
Neni 10.....	10
Formularët	10
Neni 11.....	10
Ruajtja e formularëve dhe librave të përdorur.....	10
Neni 12.....	10
Ndalja dhe kufizimi i transportit	10
P J E S A E II	11
TRANSPORTI I UDHËTARËVE	11
Neni 13.....	11
Hapësira, salla e pritjes dhe peroni.....	11
Neni 14.....	11
Të drejtat e udhëtarëve	11
Neni 15.....	11

Detyrimet e udhëtarëve.....	11
Neni 16.....	12
Përgjashtimi nga transporti	12
Neni 17.....	12
Ankesat	12
Neni 18.....	13
Mbajtja e rendit dhe pastërtisë	13
Neni 19.....	13
Biletat e udhëtimit	13
Neni 20.....	13
Pajisja me bileta	13
Neni 21.....	14
Evidentimi i shitjeve të biletave të trenave	14
Neni 22.....	14
Trenat e veçantë – komerciale.....	14
Neni 23.....	14
Kategorizimi i trenave në aspektin tarifor	14
Neni 24.....	14
Hyrja në vagon dhe ulja në vend, rezervimi i vendit.....	14
Neni 25.....	15
Kontrollimi i biletave të trenit.....	15
Neni 26.....	16
Bagazhi personal	16
Neni 27.....	16
E drejta e transportit të kafshëve	16
Neni 28.....	17
Pengesat në rendin e lëvizjes së trenave.....	17
Neni 29.....	17
Pagesat plotësuese dhe gjobat	17
P J E S A III.....	19
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	19
Neni 30.....	19
Neni 31.....	19
Neni 32.....	19

Në bazë të dispozitave të nenit 34 pika 4 të ligjit për Ndërmarrje Publike 03/L-087 të dispozitave të nenit 20 të ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i dhe në bazë të nenit 7 paragrafi 2 të Statutit të Kompanisë nr. I/02 të datës 19.01.2024, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A, në Mbledhjen Nr. 24, të mbajtur më datën 27.06.2025, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT TË
UDHËTARËVE**

P J E S A I

DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1

Përmbajtja dhe zbatimi i Rregullores

1. Rregullorja rregullon organizimin e transportit të udhëtarëve dhe përmban dispozitat themelore për transportin e udhëtarëve në rrjetin e Hekurudhave të Kosovës.
2. Dispozitat e kësaj rregullore vlejné edhe për transportin e udhëtarëve në komunikacionin ndërkombëtar, përveç nëse ndonjëra prej rasteve është rregulluar ndryshe me dispozita ndërkombëtare.
3. Për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe dispozitave të saj, duhet të merret parasysh siguria, ekonomizimi dhe efikasiteti i transportit, për të cilat janë përgjegjës gjithë punonjësit e Hekurudhave të Kosovës – Trainkos Sh.A. dhe Hekurudhave të Kosovës – Infrakos Sh.A., të cilët marrin pjesë drejtpërdrejt në kryerjen dhe kontrollin e punëve gjatë transportit të udhëtarëve.
4. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të aplikueshme për rregullimin e transportit të udhëtarëve nga Ndërmarrja Publike - Hekurudhat e Kosovës – Trainkos Sh.A., dhe nëse ndonjëra nga dispozitat është rregulluar ndryshe nga akte më të larta ligjore, atëherë vlejné dispozitat dhe aktet më të larta.

Neni 2

Shkurtesat dhe Përkufizimet

1. Shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1 **HK-Trainkos SH.A.** – Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A.;
- 1.2 **HK-Infrakos SH.A.** – Hekurudhat e Kosovës Infrakos Sh.A.;
- 1.3 **Bileta** – Kuponi fiskal i lëshuar me PEF apo formë tjetër e paraparë me ligj;
- 1.4 **PEF** – Pajisja Elektronike Fiskale;
- 1.5 **CIV** – Konventa ndërkombëtare për transportin e udhëtarëve dhe bagazhit me hekurudhë;
- 1.6 **RID** – Rregullorja për transportin e materieve të rrezikshme në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar;
- 1.7 **TU** – Transporti i udhëtarëve;
- 1.8 **RIC** – Rregullorja për përdorimin e përbashkët të vagonëve të udhëtarëve në komunikacionin ndërkombëtar;
- 1.9 **PK** – Policia e Kosovës;
- 1.10 **UKT** – Udhëzimi për Komunikacion – Transport.

2. Përkufizimet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 2.1 **Ndërmarrja Hekurudhore** – Çdo ndërmarrje publike apo private, që ka biznes kryesor ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor për mallra dhe udhëtarë, duhet të siguroj tërheqjen e trenave. Kjo përfshinë gjithashtu shërbimin e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse;
- 2.2 **Transportues** - Nënkupton një ndërmarrje kontraktuale hekurudhore me të cilën një udhëtarë ka lidhur një kontratë transportimi, ose një numër ndërmarrjesh hekurudhore që operojnë njëra pas tjetres dhe që kanë detyrim sipas kësaj kontrate;
- 2.3 **Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore** – Njësia organizative përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, duke përfshirë dhënie të trasesë për trenat dhe kërkimin e pagesës për atë shfrytëzim. Gjithashtu, kjo njësi është përgjegjëse edhe për rregullimin e trafikut. Funkcionet e menaxhimit të infrastrukturës shpesh atribuohen më shumë se një njësi organizative;
- 2.4 **Rezervim** – Procesi i sigurimit të një vendi për udhëtim me tren, përmes një bilete të caktuar për një linjë dhe orar të caktuar. Kjo mund të bëhet përmes një autorizimi në letër apo në formë elektronike, që i jep të drejtë udhëtarit të udhëtojë në trenin dhe vendin që ka rezervuar;
- 2.5 **Vonesë** –Ndryshimi kohor ndërmjet kohës së nisjes/ardhjes së planifikuar të trenit, sipas orarit të publikuar;

- 2.6 **Personat me Aftësi të Kufizuar** – Nënkupton çdo person, lëvizshmëria e të cilëve është e kufizuar për shkak të paaftësisë trupore, paaftësisë intelektuale, dëmtimit intelektual ose ndonjë shkaku tjetër;
- 2.7 **Personat me Nevoja të Veçanta** – Paaftësi ose si pasojë e moshës, gjendja e të cilëve kërkon vëmendje të duhur dhe përshtatje të shërbimeve të vëna në dispozicion të të gjithë udhëtarëve, përfshirë nevojat e tyre të veçanta;
- 2.8 **Kushtet e përgjithshme të transportit** – Nënkupton transportin vendor në harmoni me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, ndërsa për transportin ndërkombëtar është e rregulluar nëpërmjet një marrëveshje të veçantë ose bilaterale;
- 2.9 **Mjetet Lëvizëse** – Nënkupton Mjetet Lëvizëse Tërheqëse (Lokomotivat për Transport të Udhëtarëve, Trenat motorikë) si dhe Mjetet Lëvizëse të Tërhequra (Vagonët e udhëtarëve).

Neni 3

Vendet zyrtare

1. Stacionet janë vende zyrtare të cilat janë të hapura për transportin e udhëtarëve.
2. Stacionet janë të hapura për secilin lloj të transportit, këto stacione theksohen në emërtimin e stacioneve të HK-ës, respektivisht nga Menaxheri i Infrastrukturës HK Infrakos Sh. A.

Neni 4

Lokalet, pajisjet, instalimet dhe mjetet tjera për punë

1. Vendet e hapura zyrtare për transport të plotë ose të kufizuar të udhëtarëve, varësisht nga vëllimi i punës dhe kushteve vendore, duhet të kenë lokale adekuate, pajisje, instalime dhe mjete të tjera të nevojshme për punë, për organizimin e transportit të udhëtarëve, e këto janë: lokalet për pritje, peronat, depot, laurat, vijat hekurudhore, vulën, instalimet e zërimit për njoftimin e udhëtarëve etj.
2. Vula e stacionit duhet të ketë emërtimin e stacionit, datën, muajin dhe vitin. Në vulë, dita dhe muaji tregohen me dy numra arab, me kusht që përpara numrit një shifror gjithnjë të shënohet »0«, ndërsa viti me më së paku dy numrat e fundit (p.sh. 08.10.25 ose 11.10.25). Muaji mund të tregohet edhe me germa (shkurt ose i plotë), p.sh. 07. Tet. 25 ose 27. Maj. 25

Neni 5

Personeli

1. Gjatë transportit të udhëtarëve, në mënyrë direkte ose indirekte, në njësitë ekzekutive marrin pjesë këta punonjës:
 - 1.1 Shefi i stacionit;
 - 1.2 Drejtuesi i trenave;
 - 1.3 Konduktori;
 - 1.4 Makinisti;
 - 1.5 Ndihmës Makinisti;
 - 1.6 Sigurimi në Tren;
 - 1.7 Revizori dhe
 - 1.8 Biletari.

2. Personeli i angazhuar për kryerjen e punëve në stacione do të varet nga vëllimi i punës. Në stacionet më të vogla, një punonjës mund të kryejë disa detyra, në varësi të organizimit të punës në stacion.

Neni 6

Organizimi i punës në stacion

1. Me kërkesë të Trainkos Sh.A., secili stacion në dokumentin teknik të stacionit, kur është e nevojshme duhet të përgatisë një proces të veçantë teknik të punës dhe të sqaroj hollësisht mënyrën e organizimit dhe veprimit gjatë transportit të udhëtarëve.

2. Dokumenti teknik i punës në stacion dhe procesi teknik i punës duhet të përmbajë:
 - 2.1 Regjistrin e të gjitha pajisjeve, instalimeve dhe mjeteve tjera të cilat shfrytëzohen gjatë transportit të udhëtarëve, me një sqarim të qartë për qëllimin e përdorimit (ndarja e biletarive të udhëtarëve, ndarja e lokaleve për pritje, peronet etj.);
 - 2.2 Regjistrimin e të gjitha vendeve për kryerjen e punëve gjatë transportit të udhëtarëve (biletaritë e udhëtarëve, informimi etj.);
 - 2.3 Orarin e punës së biletarisë për dhënien e biletave për udhëtarët;
 - 2.4 Numrin e domosdoshëm të punonjësve për çdo vend pune dhe përshkrimin e punëve për secilin vend të punës;
 - 2.5 Kohën dhe mënyrën e dorëzimit dhe pranimit të punëve;
 - 2.6 Organizimin e punëve gjatë dhënies së biletave dhe hyrjes së udhëtarëve në vagonë.

3. Gjatë organizimit të punëve, duke pasur parasysh infrastrukturën hekurudhore dhe objektet përcjellëse, duhet të merren në konsideratë edhe:
 - 3.1 Nisja e trenit të udhëtarëve – Caktimi i biletarëve për dhënien e biletave për komunikacionin vendor dhe ndërkombëtar, këndi për informim, etj.;
 - 3.2 Organizimi i dhënies së biletave për tren, shërbimi mbikëqyrës dhe kontrolli;
 - 3.3 Sigurimi i vendeve zyrtare nga zjarri, humbja, dëmtimi, fatkeqësitë natyrore etj.;
 - 3.4 Mirëmbajtja dhe pastrimi i pajisjeve, instalimeve dhe mjeteve të tjera për punë, si dhe mbikëqyrja e tyre, me angazhim konkret të punonjësve të caktuar për këto punë;

- 3.5 Selia dhe adresa e shërbimit të kontrollit, PK-së dhe organeve të tjera relevante;
- 3.6 Regjistri, adresa dhe numrat e telefonit për shfrytëzuesit potencial dhe agjencitë e udhëtarëve që kanë të drejtën e shitjes së biletave për trena: Marrja e masave të nevojshme në rast të rritjes së numrit të udhëtarëve në ditë të caktuara, përkatësisht në raste të paparashikuara;
- 3.7 Caktimi i vendeve për ruajtjen e çelësave rezervë, si dhe vendet ku vendoset materiali dhe formularët e nevojshëm për punën e mëtutjeshme;
- 3.8 Organizimi i punës duhet të bëhet në mënyrë që të arrihet siguria e komunikacionit, respektimi i shpejtësisë së lejuar gjatë transportit, menaxhimi ekonomik, ofrimi i informacionit të plotë për shfrytëzuesit të transportit dhe menaxhimi i përgjithshëm në punë.

Neni 7

Koha e punës

1. Koha e punës për dhënien e shërbimeve në transportin e udhëtarëve duhet të publikohet në tabelat e publikimeve në stacion dhe në forma të tjera informimi.

Neni 8

Orari i Lëvizjes së Trenave – OLT

1. Orari i Lëvizjes së Trenave – OLT hartohet në përputhje me ligjin për Hekurudhat e Kosovës. HK-Trainkos Sh.A. është i obliguar që në marrëveshje me Menaxherin e Infrastrukturës HK-Infrakos Sh.A., të siguroj vend dhe formë të përshtatshme për informimin e udhëtarëve rreth orarit të lëvizjes së trenave, i cili do të përmbush nevojat e udhëtarëve për orientim të drejtë në përzgjedhjen e trenave.
2. Në stacionet më të mëdha dhe në vendet turistike sipas nevojës, duhet të publikohet Orari i plotë i Lëvizjes së Trenave - OLT.

Neni 9

Organizimi i trajnimit, shkollimit të rregullt dhe mbikëqyrja e punonjësve ekzekutivë

1. HK-Trainkos Sh.A., për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në organizimin e transportit të udhëtarëve, detyrohet që në mënyrë të vazhdueshme të bëjë:
 - 1.1 Organizimin dhe mbikëqyrjen e punës së personelit;
 - 1.2 Trajnimin e personelit;
 - 1.3 Shkollimin e rregullt të personelit.
2. Mbikëqyrja duhet të bëhet në përputhje me përgjegjësitë hierarkike sipas organogramit të Ndërmarrjes. Punonjësit që janë të angazhuar në mënyrë direkte dhe indirekte në

organizimin e transportit të udhëtarëve në HK-Trainkos Sh.A. duhet të trajnohen dhe t'u nënshtrohen shkollimit të rregullt, në përputhje me rregulloret përkatëse.

Neni 10

Formularët

1. Për organizimin e punëve në transportin e udhëtarëve, përdoren formularët adekuat, të cilët rregullohen në bazë të Udhëzimit për aplikimin e kësaj Rregulloreje.
2. Formularët duhet të jenë të evidentuar dhe të vulosur.

Neni 11

Ruajtja e formularëve dhe librave të përdorur

1. Formularët dhe librat e përdorur për transportin e udhëtarëve duhet të ruhen në përputhje me Ligjin për Arkivimin.
2. Nëse për ndonjë çështje hetimet janë ende në vazhdim, të gjithë formularët dhe librat që kanë të bëjnë me atë çështje duhet të ruhen deri në përfundimin e plotë të hetimeve.

Neni 12

Ndalja dhe kufizimi i transportit

1. Në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Republikës së Kosovës 03/L-076, organet e shtetërore të autorizuara mund të ndalin ose të kufizojnë (kushtëzojnë) transportin e udhëtarëve. Vendimin për ndaljen ose kushtëzimin e transportit e publikon HK-Trainkos Sh.A.
2. Transporti mund të ndalet plotësisht ose pjesërisht. Ndalja e transportit mund të kryhet përmes vendosjes së kufizimeve, të cilat publikohen nga HK-Trainkos Sh.A ose HK Infrakos Sh.A.

P J E S A E II

TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 13

Hapësira, salla e pritjes dhe peroni

1. Hapësirat dhe vendet e pritjes në stacion shërbejnë për pritjen dhe përcjelljen e udhëtarëve. Madhësia e tyre varet nga frekuentimi i udhëtarëve.
2. Në këto hapësira zakonisht gjenden informacionet për udhëtarët, biletaritë e udhëtarëve, salla e pritjes, tualetet, posta etj.
3. Hapësirat e tilla janë të pajisura me shenjat orientuese. Shkrimet mund të jenë tekstuale ose në formë elektronike.
4. Hapësirat do të jenë të hapura sipas orarit zyrtar të stacioneve. Në bazë të frekuentimit dhe nevojave të udhëtarëve, sallat e pritjes mund të jenë të klasës së dytë (2) dhe të klasës së parë (1), si dhe sallat e pritjes për nxënës, për nëna me fëmijë etj.
5. Peroni është sipërfaqja para dhe ndërmjet vijave hekurudhore, e cila është e destinuar për hyrjen e udhëtarëve në tren dhe daljen nga treni.

Neni 14

Të drejtat e udhëtarëve

1. Gjatë udhëtimit me tren, udhëtarët mund:
 - 1.1. Të marrin me vete bagazhe dore pa pagesë deri në 20 kg, të cilat mund të vendosen në vendin e caktuar për këtë qëllim;
 - 1.2. Të marrin me vete dhe të kujdesen vetë për kafshë të vogla shtëpiake, të lejueshme për transportin hekurudhor;
 - 1.3. Të dëmshpërblehen sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast aksidenti apo incidenti që ndodhin gjatë udhëtimit me tren.
2. Për problemet që mund të lindin gjatë udhëtimit me tren, udhëtari mund t'i drejtohet personelit të trenit.

Neni 15

Detyrimet e udhëtarëve

1. Udhëtarët kanë për detyrë:
 - 1.1. Të pajisen me biletë udhëtimi nga biletarët ose nga konduktori;

- 1.2. Të ruajnë biletën e udhëtimit në gjendje të mirë deri në fund të udhëtimit dhe ta paraqesin kur kërkohet nga konduktori dhe kontrolli;
 - 1.3. Të mbajnë pastër vendin e qëndrimit;
 - 1.4. Gjatë kalimit nga një tren në tjetrin në stacione, të kujdesen vetë për mbajtjen e gjërave personale.
2. Udhëtarëve u ndalohe:
- 2.1. Transportimi i lëndëve djegëse, piroteknike, helmuese dhe lëndëve të tjera të kësaj natyre;
 - 2.2. Hipja në tren pasi të jetë dhënë sinjali për nisjen e tij;
 - 2.3. Prishja e qetësisë në tren dhe shqetësimi i udhëtarëve të tjerë
 - 2.4. Përkulja nga dritaret, hapja e dyerve të vagonit, qëndrimi në urat kaluese, në dyer, shkallë kur treni është në lëvizje;
 - 2.5. Hedhja e mbeturinave nga vagoni;
 - 2.6. Ndotja e mjedisit në stacion dhe në vagon;
 - 2.7. Pirja e duhanit në tren;
 - 2.8. Konsumimi i pijeve alkoolike dhe narkotikëve;
 - 2.9. Keqpërdorimi i frenit të sigurimit.

Neni 16

Përrjashtimi nga transporti

1. Udhëtarët mund të përjashtohen nga transporti në stacionin më të afërt në rastet kur:
 - 1.1. Shkelin rregullat e përcaktuara në nenin 15;
 - 1.2. Cenojnë rregullat e sigurisë;
 - 1.3. Me veprimet e tyre shqetësojnë rëndë udhëtarët e tjerë;
 - 1.4. Shkelin rregullat e përcaktuara për rendin publik.
2. Personat me sëmundje kronike, ngjitëse ose të dyshuara nuk mund të udhëtojnë me tren, përveç në raste të caktuara, kur ka kërkesa për udhëtime të tilla dhe HK-Trainkos Sh.A., do të siguroj hapësira të mbyllura adekuate dhe përcjellje të veçantë (në qoftë se e lejojnë mundësitë).

Neni 17

Ankesat

1. HK-Trainkos Sh.A., është e detyruar të publikojë procedurën për trajtimin e ankesave lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Udhëtarët mund të paraqesin ankesat në zyrat e HK-Trainkos Sh.A., nëpërmjet e-mailit zyrtar, numrit zyrtar të telefonit si dhe kutisë së ankesave.
3. Ankesat dhe Kërkesat nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të shqyrtohen brenda një afati prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të tyre.

Neni 18

Mbajtja e rendit dhe pastërtisë

1. Të gjitha hapësirat e destinuara për nevojat e udhëtarëve dhe vagonët e udhëtarëve në trena duhet të mirëmbahen në gjendje të mirë dhe të pastër.
 1. Përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në stacione është Menaxheri i Infrastrukturës.
 2. Përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë për mjetet e tërhequra dhe tërheqëse është HK-Trainkos Sh.A.

Neni 19

Biletat e udhëtimit

1. Bileta e udhëtimit është dëshmi për lidhjen e kontratës për transport. Ajo i jep udhëtarit të drejtën që brenda afatit të caktuar, të udhëtojë me tren në relacionin, klasën dhe llojin e trenit të theksuar në biletë.
2. Para nisjes dhe gjatë udhëtimit, udhëtarët pajisen me bileta të trenit në stacione dhe nga konduktorët (stacionet që nuk kanë biletari).
3. Forma dhe përmbajtja e biletave të udhëtimit do të rregullohen në bazë të udhëzimit përkatës.

Neni 20

Pajisja me bileta

1. Udhëtarët duhet të pajisen me bileta udhëtimit nga personat e autorizuar, stacionet e trenit – biletaritë, dhe në tren nga konduktorë, si dhe nga agjencionet, të cilat në marrëveshje me HK-Trainkos Sh.A. kryejnë shitjen e biletave.
2. Në momentin e pagesës, udhëtarët duhet të pajisen me biletën ose një formë tjetër zyrtare të dhënies së biletës (kuponi fiskal), e cila do të specifikohet në udhëzimin përkatës.

Neni 21

Evidentimi i shitjeve të biletave të trenave

1. Evidentimi i shitjeve të biletave, të shitura nga biletaritë, konduktorët apo mekanizma të tjerë kompetentë, bëhet nëpërmjet raporteve ditore, javore, mujore etj., përmes arkave fiskale ose mënyrave të tjera të parapara me ligj.

Neni 22

Trenat e veçantë – komerciale

1. HK-Trainkos Sh.A., ofron organizimin e transportit të udhëtarëve komercial, konform kërkesave specifike që trajtohen nga Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit – DPZHB, duke u bazuar në dokumentet e tjera të brendshme.
2. Evidentimi i shitjeve për trenat e veçantë–komerciale, realizohet përmes kontratave të veçanta specifike të parapara me ligj.

Neni 23

Kategorizimi i trenave në aspektin tarifor

1. Kategorizim tarifor i trenave në komunikacionin e përbashkët saktësohet me marrëveshje ndërmjet entiteteve të interesuara. Gjatë saktësimit të kategorizimit të trenave në aspektin tarifor, zbatohen kriteret që shprehin politikën e përbashkët afariste në momentin aktual, duke u bazuar në situatën në tregun e transportit dhe konkurrencës. Në këtë proces vëmendje e veçantë i kushtohet kushteve specifike të secilit rajon dhe relacion, shpejtësisë komerciale, komoditetit, kohës së nisjes dhe mbërritjes së trenit, etj.
2. Kategorizimi i trenave në aspektin tarifor publikohet në orarin e lëvizjes së trenave të udhëtarëve, si dhe në udhëzimet adekuate.

Neni 24

Hyrja në vagon dhe ulja në vend, rezervimi i vendit

1. Në vagonët ku nuk bëhet rezervimi i vendit për ulje, udhëtarët mund të ulen dhe të zënë ulëset sipas dëshirës, përveç vendeve të përcaktuara për personat me nevoja të veçanta.
2. Kërkesat e tjera të veçanta për rezervimin vendeve apo edhe vagonëve do të rregullohen me udhëzimin përkatës.

Neni 25

Kontrollimi i biletave të trenit

1. Kontrollimin e pajisjeve dhe biletave të trenit e bëjnë konduktori, revizori dhe organet e tjera kontrolluese të autorizuara nga HK-Trainkos Sh.A.
2. Detyrat themelore të konduktorit janë:
 - 2.1 Të kujdeset për hyrjen e sigurt të udhëtarëve në tren, akomodimin e tyre të drejt, vendosjen e bagazhit personal, si dhe për daljen e tyre nga treni;
 - 2.2 Kontrollimin dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta në tren;
 - 2.3 Kujdeset për rendin, pastërtinë, ngrohjen, ajrosjen dhe ndriçimin e vagonëve që i ka nën mbikëqyrje;
 - 2.4 Të kujdeset për sigurinë dhe akomodimin e udhëtarëve gjatë transportit;
 - 2.5 Të jap informata të sakta dhe të qarta;
 - 2.6 Kryen edhe detyra të tjera të parapara me akte të tjera.
3. Parregullsitë që ndikojnë në sigurinë dhe komoditetin e udhëtarëve duhet të mënjanohen me shërbimet adekuate në stacionin e parë ose në stacionin kthyes fundor. Nëse ndodhë ndonjë parregullsi gjatë rrugës, konduktori është i obliguar të mënjanojë menjëherë ose të marr masa brenda mundësive të tij për të shmangur pasojat e kësaj parregullsie. Për të gjitha parregullsitë, konduktori harton një raport të shkruar në stacionin amë pas mbërritjes.
4. Detyrat themelore të Sektorit për Siguri, Kualitet dhe Kontroll – SKSK janë:
 - 4.1 Verifikon përbërjen e trenit dhe numrin e konduktorëve që e shoqërojnë trenin;
 - 4.2 Kontrollon punën e konduktorëve në aspektin e kryerjes së detyrave dhe rregullshmërinë e pajisjeve fiskale (pllomba-sticker);
 - 4.3 Siguron që udhëtarët janë të pajisur me bileta;
 - 4.4 Kryen kontrollimin e biletave të trenit;
 - 4.5 Kontrollon shitjen e biletave në biletari;
 - 4.6 Mbledhë dhe verifikon të dhënat për trenat, nëse ata i përgjigjen nevojave të udhëtarëve nëpër relacione (*sugjerimet, vërejtjet, dhe propozimet e udhëtarëve lidhur me orarin e lëvizjes së trenave, punën e punonjësve të hekurudhës dhe komoditetin e udhëtimit*);
 - 4.7 Kontrollon funksionimin e instalimeve, pajisjeve dhe inventarit të vagonëve;
 - 4.8 Kontrollon punën dhe sjelljen e punonjësve që kryejnë veprimtari shërbyese në tren;
 - 4.9 Verifikon ngrohjen, pastërtinë dhe mirëmbajtjen e rendit në tren dhe në lokalet e stacioneve të destinuara për nevoja të udhëtarëve;
 - 4.10 Kryen edhe detyra tjera të parapara me akte tjera.

5. Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit – SKSK harton raportet të rregullta me shkrim (*formularët mbi kontrollimet e kryera*), ku duhet të evidentohen parregullsitë e konstatuara, masat e ndërmarra për mënjanimin e tyre, sugjerimet mbi problemet dhe propozimet në lidhje me rendin e lëvizjes së trenave, shfrytëzimin e trenave, organizimin e shërbimit për transportin e udhëtarëve në stacione, si dhe vërejtjet dhe propozimet e udhëtarëve.
6. Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit – SKSK udhëheq evidencat për të dhënat e mbledhura që janë të nevojshme për analizën e punës.
7. Për parregullsitë që lidhen me punën e konduktorëve Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit – SKSK i drejtohet Departamentit të Operimeve Hekurudhore përmes KE-së. Ndërsa për parregullsitë që lidhen me punën e biletashitësve në stacione, Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit – SKSK kërkon nga HK Infrakos Sh.A., përmes KE-se (*sipas Marrëveshjes për Shërbime të Përbashkëta në fuqi dhe Ekspozeut të Rrjetit*).

Neni 26

Bagazhi personal

1. Udhëtari ka të drejtën që pa pagesë të marr me vete si bagazh personal gjësendet që mund të futen dhe vendosen lehtësisht në vagon, mbi ose nën ulësen në të cilën është ulur, për sa kohë kjo nuk bie ndesh me rregullat doganore dhe rregullat tjera, dhe nuk dëmton vagonët.
2. Vendosja e bagazhit personal nuk lejohet në ulëse, ura kaluese të vagonëve dhe në korridore, sipas rregullave.
3. Gjësendet që janë të ndaluara sipas dispozitave të RID-it dhe tarifës së udhëtarëve, nuk mund të transportohen si bagazh personal.
4. Ndalesat nga paragrafi 3 do të zbatohen nga konduktori/revizori.
5. Bagazhi që kalon përmasat e lejuara (të pranueshme si bagazh personal apo si bagazh personal nga personeli), duhet të vendoset në vagonin zyrtar, nëse kjo është e mundur. Në të kundërtën, konduktori cakton vendin ku udhëtari dhe bagazhi personal do të vendosen.

Neni 27

E drejta e transportit të kafshëve

1. Për të siguruar kushte komode për transportin e udhëtarëve si rregull, kafshët e gjalla nuk lejohen të futen në vagonët e udhëtarëve.

2. Në vagonët e udhëtarëve mund të lejohet futja e kafshëve të vogla shtëpiake, të mbyllura në kafaz, shporta ose ambalazhe të tjera të përshtatshme, me kusht që ky transport të mos cenojë dispozitat veterinare dhe sanitare.
3. Shpendët dhe kafshët e imta nuk konsiderohen si kafshë shtëpiake.
4. Qentë e vegjël mund të futen në vagon, edhe nëse nuk janë të mbyllur në kafaz, me kusht që udhëtari t'i mbajë në prehër. Si qen i vogël konsiderohet ai me lartësi deri në 40 cm, matur nga toka deri te kurrizi.
5. Mbikëqyrja e kafshëve që udhëtari merr me vete në vagon është përgjegjësi e udhëtarit.
6. Udhëtari është përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara nga kafshët që ai merr me vete në vagon, përveç kur ai provon se dëmi është shkaktuar nga një gabim i transportuesit hekurudhor ose nga një gabim i një të treti.
7. Me udhëzim të transportit të udhëtarëve, do të parashikohen kushtet e veçanta për transportin e qenve të institucioneve të sigurisë.

Neni 28

Pengesat në rendin e lëvizjes së trenave

1. Vonesa e trenave për transportin e udhëtarëve më shumë se 10 minuta në stacion publikohet përmes shpalljes, instalimeve të zërimit, ose edhe formave të tjera të informimit nga Menaxheri i Infrastrukturës.
2. Çdo pengesë në komunikacion (mungesa e trenit, aksidentet etj.) duhet të publikohet menjëherë, duke theksuar rrugën alternative dhe kryerjen e obligimeve të HK-Trainkos Sh.A., sipas kontratës për transport.
3. Nëse udhëtari, për shkak të vonesës së trenit, mungesës së trenit ose pengesave në komunikacion, është penguar të vazhdojë udhëtimin me tren sipas orarit të lëvizjes së trenave mund të kërkojë:
 - 3.1. Kthimin e mjeteve të pagesës së biletës;
 - 3.2. Të kthehet pa pagesë me trenin e parë të përshtatshëm në stacionin fillestar ose të vazhdojë udhëtimin.

Neni 29

Pagesat plotësuese dhe gjobat

1. HK-Trainkos Sh.A., ka të drejtën të aplikojë pagesë plotësuese për personat që nuk pajisen me biletë në stacionin ku ofrohet shërbimi i pajisjes me bileta. Gjithashtu, ka të

drejtë të aplikojë gjobën në rastet kur udhëtarët i shmangen qëllimshëm pajisjes me bileta.

2. Lartësia e pagesës plotësuese/gjobës dhe rastet kur aplikohet, rregullohen sipas udhëzimit për aplikimin e kësaj rregulloreje dhe tarifave zyrtare.
3. Pagesat plotësuese do të aplikohen nga konduktoret, ndërsa gjobat do të aplikohen nga konduktoret dhe revizoret.

P J E S A III
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Të gjitha detyrimet që dalin nga kjo Rregullore duhet të zbatohen nga HK-Trainkos Sh.A., dhe HK Infracos Sh.A., sipas Ekspozeut të Rrjetit dhe Marrëveshja për Shërbime të Përbashkëta.

Neni 31

Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen dispozitat e rregullores së mëparshme mbi organizimin e transportit të udhëtarëve.

Neni 32

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Jetmir Nuka
Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.